



KOLEGJI ILIRIA

Licencuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - Akredituar nga Agjencia e Kosovës për Akreditim
Rruga Gazmend Zajmi Nr. 75 Prishtinë, Tel: +381 (0) 38 233 951 E-mail: info@uiliria.org Web: www.uiliria.org

Bazuar në Vendimin me Nr.01/07, të datës 11.03.2020, Vendimin me Nr.01/16 të datës 26.03.2020, si dhe Vendimin me Nr.01/22, të datës 05.04.2020 të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Statutit të Kolegjit ILIRIA me Nr. 1960/19 si dhe bazuar në Mbledhjen e mbajtur të Senatit të Kolegjit me datë 06.04.2020. Senati mori këtë:

Ref: 221/20

VENDIM

- I. Për vazhdimin e ndërprerjes së procesit edukativo-arsimor në mënyrë fizike nga 07.04.2020 deri 30.06.2020, për të gjitha nivelet dhe programet e fakulteteve të cilat veprojnë pranë Kolegjit ILIRIA, mirëpo vazhdon procesi mësimor në distance/në mënyrë elektronike (online), ndërsa provimet do të mbahen fizikisht në ambientet e Kolegjit ILIRIA.
- II. Vazhdimi i ndërprerjes (pezullimit) të punës në mënyrë fizike vlenë edhe për stafin administrativ, përderisa punët administrative urgjente dhe të nevojshme kryhen edhe nga shtëpia, në mënyrë elektronike.
- III. Konstatohet se vazhdimi i ndërprerjes bëhet me arsyetimin që është ende e nevojshme izolimi i qytetarëve për parandalimin e përhapjes së virusit që konsiderohet pandemi botërore Covif-19, si dhe respektimi i masave preventive nga IKShPK kundër përhapjes së virusit Covid-19.
- IV. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Senati pranë Kolegjit ILIRIA.
- V. Vendimi konsiderohet i plotëfuqishëm menjëher pas nënshkrimit, deri në marrjen e një vendimi tjetër.

Arsyetim

Duke u bazuar në vendimin me Nr. 01/07 të datës 11.03.2020, Vendimin me Nr. 01/16 të datës 26.03.2020, si dhe Vendimin me Nr.01/22, të datës 05.04.2020 të lëshuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, vendime për ndërprerje të procesit edukativo-arsimor në institucionet publike dhe private, si dhe vazhdimin e ndërprerjes së procesit edukativo arsimor, po ashtu bazuar në përhapjen e virusit COVID-19 e konstatuar si pandemi botërore, Senati i Kolegjit Iliria merr vendimin për pikat e lartcekura.

Vendimi për vazhdimin e ndërprerjes së procesit edukativo-arsimor si masë preventive për përhapjen e virusit Covid-19, duke respektuar të gjitha masat të cilat janë marrë nga IKShPK kundër përhapjes së virusit vdekjeprurës. Vazhdimi i ndërprerjes së procesit edukativo mësimor, si dhe vazhdimi i ndërprerjes (pezullimit) të punës në mënyrë fizike vlenë edhe për stafin administrativ dhe do të bëhet deri më datë 30.06.2020.

Andaj Kolegji ILIRIA vendosi si në dispozitiv të vendimit

Prishtinë: 06.04.2020

Vendimi i dorëzohet;

1. Senatit të Bordit
2. Zyrës Ligjore
3. Arkivës së Kolegjit

Rektori i Kolegjit ILIRIA

